



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

RELACION

Data	
Nr. Prot	

PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MIRDITË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”, ZJ. MARINA FREDERIK VORFI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njih shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 3218 prot., datë 04.09.2023, Këshilli i Bashkisë Mirditë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari zj. Dila Preng Prenga, propozuar nga subjekti politik Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë, për Këshillin e Bashkisë Mirditë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, zj. Marina Frederik Vorfi.

Me shkresën nr. 6794, prot., datë 08.09.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Mirditë, zj. Marina Frederik Vorfi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit zgjedhor të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 21426 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Marina Frederik Vorfi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Marina Frederik Vorfi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Marina Frederik Vorfi, në Këshillin e Bashkisë Mirditë, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Marina Frederik Vorfi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Marina Frederik Vorfi, në Këshillin e Bashkisë Mirditë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MIRDITË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”, ZJ. MARINA FREDERIK VORFI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3218 Prot., datë 04.09.2023, Këshilli i Bashkisë Mirditë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari zj. Dila Preng Prenga, i propozuar nga subjekti politik Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Këshillin e Bashkisë Mirditë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, zj. Marina Frederik Vorfi.

Me shkresën nr. 6794 Prot., datë 08.09.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mirditë, zj. Marina Frederik Vorfi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë me kandidatin nga lista shumemërore e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Marina Frederik Vorfi”

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit zgjedhor të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 21426 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Marina Frederik Vorfi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Marina Frederik Vorfi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Marina Frederik Vorfi, në Këshillin e Bashkisë Mirditë, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Marina Frederik Vorfi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Marina Frederik Vorfi, në Këshillin e Bashkisë Mirditë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Marina Frederik Vorfi.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI